



Republika e Kosovës - Republika Kosova -
Republic of Kosova

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
/ Ministry of Culture, Youth and Sports

Prishtinë, nëntor 2023

THIRRJE PËR VOTIM

për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në bashkëpunim me CiviKos hap thirrjen për votim për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Përfaqësuesi rinor i Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor do të përzgjidhet nga organizatat e shoqërisë civile, përmes procesit të votimit në një organizatë një votë, proces ky që organizohet nga Platforma CiviKos.

Rreth RYCO-s

Në kuadër të Procesit të Berlinit, gjatë Samitit të Ballkanit Perëndimor 2016 në Paris, është nënshkruar Marrëveshja mbi themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor nga gjashtë vende (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia). Vizioni i RYCO-s është mbështetja e të rinjve si grupi më me interes për të promovuar frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit.

Autoriteti më i lartë për vendimmarrje i RYCO-s është Bordi Drejtues, i përbërë nga dy përfaqësues nga secili vend: një përfaqësues nga qeveria dhe një përfaqësues rinor.

Biografitë e kandidatëve që janë në garë mund ti gjeni më poshtë

Procesi i votimit

Të drejtë votimi kanë OJQ-të në Republikën e Kosovës. OJQ-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Secila organizatë mund të votojë për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim, sipas parimit 'një organizatë - një votë'.

Rikujtojmë se në rastin e votimit të shumëfishtë nga e njëjta organizatë, votat e saj do të konsiderohen të pavlefshme. Gjithashtu, do të konsiderohet e pavlefshme vota e organizatës, e cila nuk ka ngarkuar dokumentacionin si më poshtë ose ka shkelur afatin e votimit.

Format e votimit:

Ka tri mënyra që organizatat e regjistruara në Kosovë mund të votojnë:

1. Me email duke dërguar dokumentet të skanuara në emailin info@civikos.net
2. Me postë në pliko të mbyllur duke dërguar në adresën: Platforma CiviKos Rr. Bedri Pejani 7/A, 10000 Prishtine
3. Apo fizikisht në zyre, Adresa: rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtina (nga ora 10:00-16:00)

Dokumentet që duhet të dorëzohen për votim:

1. Fletëvotimi, i plotësuar (të rrethohet numri rendor i kandidatit/es që votoni);
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së.
3. Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga Drejtori/Drejtoresha e OJQ-së, për votim në këtë proces.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve përfaqësuesit e MKRS-së dhe të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve.

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit info@civikos.net ose numrit të telefonit 038 224 904.

Për më shumë informacion rreth Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ju lutemi vizitoni <https://www.rycowb.org/>.

Biografite e kandidatëve

1. Donika Zogu

Donika Zogu, është lindur me 13.07.2001 në Drenas. Qysh në moshë të re dallohet për aktivizëm rinor dhe punë vullnetare. Ajo ka një përvojë të gjatë në shoqëri civile ku për më shumë se 5 vite, është angazhuar në shkrim, menaxhim dhe implementim të projekteve, përmes të cilave ka ndikuar në zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë! Donika sapo ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin Filozofik, Departamenti Punë Sociale dhe në Universitetin AAB në Fakultetin e Arteve, drejtimi Dizajn i Modës. Aktualisht, Donika udhëheq dhe menaxhon me programet ndërkombëtare në LDA Europe ku është edhe anëtare e Bordit për Ballkanin Perëndimor. Ajo gjithashtu është edhe Kryetare e KVRL- Drenas, anëtare e Bordit në Dialogun Civil Kosove- Serbi, Koordinatore e Festivalit “Muaji i Mërgatës”, anëtare e Komisionit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe vullnetare në Kryq të Kuq.

Këto janë disa nga angazhimet aktuale të Donikes, kurse ajo në të kaluarën, veprimtarinë e saj e ka shtrirë edhe në disa fusha të ndryshme ku ka dhënë kontribut, si anëtare e Komisionit Komunal Zgjedhor, përfaqësuese në Këshillin e Nxënësve të Kosovës, Trajnere për Edukim Medial dhe Literature Mediatike, praktikante në Ministrinë e Drejtësisë në Departamentin e Politikave Sociale, etj.

Donika njihet si profesioniste e orientuar drejt rezultateve dhe shumë e motivuar me një histori të dëshmuar në menaxhim dhe shkrim të projekteve. Ajo i njeh mirë punët që i kryen tash e sa vite si trajnere për Soft Skills, Mendim Kritik, Menaxhim të Kampanjave, Të folurit në publik, lidërsip, etj.

Është zë i fuqishëm në avokimin e të drejtave të të rinjve, duke synuar në ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e të rinjve në vendimmarrje.

2. Gjylmser Nallbani

Gjylmseri u njoh me sektorin e shoqërisë civile në fund të vitit 2016, ku njohuritë e marra nga studimet e saj për drejtësi u vunë në praktikë në punën e përditshme duke u angazhuar në avokimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Fokusi i saj kryesor ka qenë ofrimi i edukimit joformal për të rinjtë duke i pajisur ata me njohuri për të drejtat dhe përgjegjësit e tyre, qasje në drejtësi dhe angazhimin efektiv në proceset vendimmarrëse, vëmendje i'u kushtua rritjes së pjesëmarrjes së vajzave dhe grave të reja, duke synuar formimin e brezave që janë më kërkues dhe që kuptojnë vlerat e qytetarisë aktive. Duke qenë pjesë e disa organizatave joqeveritare, ajo ka koordinuar projekte, ka mentoruar dhe monitoruar organizata më të vogla të udhëhequra nga vajza dhe gra në ofrimin e mbështetjes programatike dhe administrative për zhvillimin e kapaciteteve të tyre menaxheriale dhe drejtuese, dhe duke i mbështetur ato gjatë hartimit dhe zbatimit të nismave të tyre avokuese për barazi gjinore.

Aktualisht është pjesë e organizatës joqeveritare ndërkombëtare CARE International Balkans dhe është e përfshirë në zbatimin dhe administrimin e skemës së Mbështetjes Financiare për Palët e Treta, duke ofruar mbështetje financiare për të rinjtë me më pak mundësi për të zhvilluar iniciativa avokuese, programe të praktikës, koordinimin e trajnimeve për të rritur aftësitë e punësimit të të rinjve dhe ofrimin e nën-granteve.

Përkushtimi dhe kontributi i Gjylymserit kanë fituar njohjen e saj nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Ajo u nominua dy herë dhe u shpërblye për pjesëmarrjen e saj në programin International Visitor Leadership Program (IVLP) në projektet "Të Rinjtë dhe Angazhimi Qytetar" në vitin 2022 dhe "Vullnetarizmi dhe Veprimi Qytetar" në vitin 2023. Si rezultat i pjesëmarrjes së saj në programin IVLP, asaj i'u dha çmimi "IVLP Impact Awards" në qershor 2023 duke kontribuar kështu më tej për të rinjtë dhe komunitetin. Ajo ka diplomë Bachelor në Drejtësi nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe aktualisht është në vijim të studimeve master në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative.

3. Avi Gashi

Avi Gashi është aktivist i shoqërisë civile i cili agjendë kryesore ka fuqizimin e rinisë. Për më shumë se 10 vite është angazhuar në çështje të ndryshme sociale, me qëllim avancimin e Kosovës dhe përmirësimin e jetës në Kosovë. I bindur se rinia e Kosovës ka një talent dhe potencial të jashtëzakonshëm dhe në shumë fusha, temë kryesore e agjendës së tij është fuqizimi i rinisë në Kosovë. Avokimi për bursa, për njohje të punës vullnetare, për mundësi për punë praktike, për përfshirje në vendimmarrje, qendrat rinore, infrastruktura mbështetëse etj janë vetëm disa nga temat në të cilat Avi ka kontribuar vazhdimisht. Avi ka diplomuar në Programin për Menaxhim të Qëndrueshëm Publik në Universitetin e Malmos, poashtu ka mbaruar Akademinë Politike për Social-Demokraci nga Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung. Përvoja e punës përfshin angazhim si Gazetar Hulumtues në Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese BIRN në emisionin Jeta në Kosovë, Gazetar në Kosovo2.0, Koordinator për Marketing dhe Komunikim me Publikun në Prishtina International Film Festival PRIFEST, OJQ Germin dhe Kompania Trembelat Sh.P.K

Avi nga viti 2019 është përfaqësues i Shoqërisë Civile në Këshillin Nacional të Shoqërisë Civile për Bashkëpunim me Qeverinë, ku për 2 vite ka kontribuar si Koordinator i Objektivit të 2-të për Financim të Qëndrueshëm. Aktualisht udhëheq komunitetin global të rinisë të themeluar nga Forumi Botëror Ekonomik – Global Shapers Prishtina, si dhe është Drejtor i OJQ Qendra e Rinisë Drenas. Ndërsa, kontribuon vullnetarisht në grupin punues ndërinstytucional për Dizajnimin e Strategjisë Nationale për Rini.